VENDIM
Nr. 425, datë 15.5.2013

PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga funksioni, për shkak të përfundimit të mandatit, të tre anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë vijon:

- z. Nezir Haldeda;
- z. Ylber Bezo;
- z. Sotiraq Dhamo.

2. Mandatimin, si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të:

- znj. Anila Çili, propozuar nga Ministri i Financave;
- z. Fran Brahimaj, propozuar nga Ministri i Financave;
- znj. Vjollca Karapici, propozuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë.

3. Rimandatimin, si anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të z. Agim Binaj, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha